



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

KPPP.nr.580/22

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti i Përgjithshëm, Gjyqtari Gent Bekeri, në çështjen përmbarimore të kreditorit “PREMIJA za Proizvodnju, Trgovinu u Usluge” D.O.O., e regjistruar në Serbi me NRB: 07507658982, me seli në rrugën “Mur bb - 36300” Novi Pazar, të cilën e përfaqëson sipas autorizimit Avokat A.D., kundër debitorit N.T “DAJA” B.I., me NRB: 80011431, me seli në Zonën Industriale - Prishtinë, të cilën e përfaqëson sipas autorizimit Shoqëria e Avokatëve “SCLR Partners” Sh.p.k., duke vendosur lidhur me prapësimin e debitorit, të ushtruar kundër Urdhrit Përmbarimor P.nr.332/18 të datës 06.02.2018 të Përmbaruesit Privat Eset Murati me seli në Prishtinë, jashtë seancës me datën 18.08.2023, merr këtë:

A K T V E N D I M

- I. REFUZOHET në tërësi si i pa bazuar prapësimi i debitorit N.T “DAJA” B.I., i paraqitur kundër Urdhrit Përmbarimor P.nr.332/18 të datës 06.02.2018 të Përmbaruesit Privat Eset Murati.
- II. MBETET në fuqi Urdhri Përmbarimor P.nr.332/18 të datës 06.02.2018 të Përmbaruesit Privat Eset Murati.

A r s y e t i m

Përmbaruesi Privat, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit, ka lëshuar Urdhrit Përmbarimor P.nr.332/18 të datës 06.02.2018, me të cilin ka lejuar përmbarimin, në bazë të dokumentit të besueshëm – Faturës me nr.607 të datës 07.09.2016 me Urdhër Nr.4-257 dhe DUD, ku e ka urdhëruar debitorin që në afat prej 7 ditësh pas pranimit të këtij urdhri t’ia paguaj borxhin total kreditorit në shumë prej 1,000.00 €, me kamatë ligjore prej 8%, nga rënia në vonesë e deri në ditën e pagesës definitive si dhe shpenzimet e procedurës përmbarimore në pajtim me UA-MD-së

nr.06/2014 dhe të gjitha shpenzimet që do dalin gjatë procesit, nën kërcënim të përmbartimit me dhunë.

Debitori në prapësimin e paraqitur brenda afatit ligjor, përmes përfaqësuesit të autorizuar ka kundërshtuar urdhrin përmbartimor, ndër të tjera ka theksuar se nuk i konteston shërbimet e transportit që i ka kryer kreditori mirëpo e konteston pretendimin e kreditorit se një pjese e kësaj shume nuk është paguar. Në vazhdim deklaron se urdhërpagesa ndërkombëtare e vërteton se transferimi i shumes prej 2,300.00 € është kryer me sukses. Andaj i propozon Gjykatës ta aprovoj në tërësi si të bazuar prapësimin, anuloj Urdhrin Përmbartimor P.nr.332/18 si dhe të detyrohet kreditori t'i kompensoj shpenzimet e përpilimit të prapësimit sipas tarifës së OAK-së.

Kreditori në përgjigjen në prapësim të paraqitur brenda afatit ligjor, ka kundërshtuar në tërësi thëniet e debitorit në prapësim si të pa bazuara dhe se të njëjtat nuk qëndrojnë, ashtu që qëllimi i vetëm i debitorit është vonesa dhe shtyrja e përmbartimit. Tutje thekson se prova e cila është bashkangjitur si dëshmi e kryerjes së borxhit i referohet një fature tjetër e cila nuk është objekt i kësaj procedure, e cila ka të njëjtën shumë mirëpo i referohet një shërbimi tjetër të transportit. Në vazhdim deklaron se debitori qëllimisht nuk i referohet numrit të faturës por numrit të logos së kreditorit andaj duke u bazuar në të lartcekurat i ka propozuar Gjykatës që prapësimi i debitorit të refuzohet si i pa bazuar, si dhe në rast të ankesës të detyrohet debitori ta paguaj garancionin.

Gjykata në ri procedurë duke vepruar sipas vërejtjeve të Gjykatës së Apelit sipas vendimit AC.nr.2736/2019 të datës 16.07.2020, e pas shqyrtimit të pretendimeve të debitorit të paraqitura në prapësim, përgjigjes në prapësim të kreditorit dhe pas shqyrtimit dhe vlerësimit të provave që gjenden në shkresat e lëndës, duke iu referuar dispozitave të nenit 69 dhe 71 të Ligji Nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbartimore, (tutje LPP), gjeti se prapësimi i debitorit është në tërësi i pa bazuar, andaj, të njëjtin e refuzoi dhe vendosi si në dispozitiv të këtij Aktvendimi, për shkaqet si në vijim:

Gjykata vlerëson se në rastin konkret fatura në bazë të së cilës është lejuar urdhri për përmbartim, i plotëson kushtet për të qenë dokument i besueshëm dhe i përmban të gjitha elementet e kërkuara dhe janë të përshtatshme për përmbartim, bazuar në dispozitat e nenit 29 par.3 dhe 37 të LPP-së.

Sipas nenit 29 par.1 të LPP-së, përcaktohet se *“Përmbarimi me qëllim të realizimit të kërkesës në të holla caktohet edhe në bazë të dokumentit të besueshëm”*, ndërsa me neni 29 par. 3 të LPP-së, përcaktohet se *“Dokumenti i besueshëm është i përshtatshëm për përmbarim po qe se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, lloji, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit monetar “*. Me nenin 37 të LPP-së, përcaktohet se *“Kur propozimi për përmbarim paraqitet në bazë të dokumentit të besueshëm, mjafton që propozimit t’i bashkëngjitet dokumenti i tillë origjinal apo kopja e tij e vërtetuar sipas ligjit.”*, ndërsa sipas nenit 29 paragrafit 1 nën paragrafit 1.3 të LPP-së, fatura është përcaktuar si dokument i besueshëm sipas të cilit mund të caktohet përmbarimi për realizimin e kërkesës në të holla.

Gjykata vlerëson se urdhri i lejuar nga ana e përmbaruesit privat bazohet në dokumentin e besueshëm – Fatura Nr.607 e datës 07.09.2016 me Urdhër Nr.4-257 dhe DUD; i përmban të gjitha tiparet e dokumentit të besueshëm sipas nenit 29 par. 3 të LPP-së, meqenëse në këtë faturë janë treguar palët, përkatësisht kreditori dhe debitori, janë të përshkruara mallrat të cilat kanë qenë objekt i kësaj fature dhe është përcaktuar shuma e cila përben detyrim për përmbushje nga ana e debitorit, si dhe koha e përmbushjes së këtij detyrimi.

Gjykata vlerësoi pretendimet e debitorit rreth përmbushjes së pagesës nga e debitorit, dhe gjeti se të njëjtat janë të pabazuara, për shkak se në urdhërpagesën e paraqitur nga debitori me nr. 351582922 të datës 19.09.2016 nuk specifikohet numri i faturës për të cilën përmbushet obligimi mirëpo është përshkruar numri i cili në çdo faturë figuron i njëjtë.

Andaj bazuar në të lartcekurat, Gjykata vlerëson se në rastin konkret nuk ekziston asnjëra nga bazat ligjore mbi bazën e të cilave do të mund të anulohet urdhri për lejimin e përmbarimit nga shkaqet e parashikuara në nenin 71 të LPP-së, ndërsa në kuptim të nenit 73 të LPP-së, lidhur me prapësimin e debitorit ka vendosur jashtë seancës gjyqësore.

Gjykata vlerësoi edhe pretendimet tjera të debitorit të paraqitur në prapësim, mirëpo të njëjtat nuk ishin relevante për këtë çështje përmbarimore.

Nga arsyet e paraqitura më lart dhe duke u bazuar në nenin 73 të LPP-së, nenin 13 par.1 nën par 1.2 të Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë Departamenti për Çështje Ekonomike

KPPP.nr.580/22, datë 18.08.2023

Gjyqtari
Gent Bkeri

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve, nga dita e pranimi të aktvendimit, në Dhomat e Shkallës së Dytë, në Gjykatën Komerciale të Kosovës, përmes Dhomave të Shkallës së Parë të kësaj Gjykate.